



Kosova dhuron 2022

RAPORTI MBI GJENDJEN E FILANTROPISË

Viti 2022 ishte vit kyç në zgjerimin e ekosistemit filantropik në Kosovë. Me shume se 3.45 milionë euro donacione u regjistruan përmes 920 rasteve unike të dhurimit. Kjo shënoi një 33% rritje krahasuar me vlerën e donacioneve të regjistruara në vitin 2021.



EUR 3,455.000
shuma e regjistruar




920
i rasteve





EUR 1.9
dhurimi për banor

Trendet e dhurimit 2018 - 2022



Kauzat

Në vitin 2022, lehtësimi i varfërisë u bë kauza më e rëndësishme, duke u rritur në 55.9% të rasteve të dhurimit nga 13.2% në vitin 2021. Fusha të tjera kyçe: dhurimi sezonal (11.7%), kujdesi shëndetësor (10.5%), mbështetja për grupet e marginalizuara (9.2%), arsimi (8.5%). Lehtësimi i varfërisë u përqendrua kryesisht në ndihmën afatshkurtër.





Donatorët

Dhurimi i shumicës individuale ishte lloji kryesor i donatorëve në vitin 2022 (33.6%), i ndjekur nga individët e identifikueshëm (29.7%), duke arritur në 63.3% të rasteve të dhurimit. Sektori i korporatave ka marrë pjesë në 20.2% të rasteve të dhurimit, dhe donacionet e diasporës përbënin 18.3% të të gjitha donacioneve, të shpërndara në të gjitha kategoritë e donatorëve.

Pranuesit

Organizatrat e shoqërisë civile u bënë përfituesit kryesorë të donacioneve në vitin 2022 (53.6%, nga 25.2% në vitin 2021), duke tejkaluar individët dhe familjet (39.3% në 2022, nga 54.1% në 2021), duke përmbysur trendet e mëparshme. Institucionet e qeverisjes lokale/qendrore dhe institucionet publike morën më pak donacione në vitin 2022.



Efektet e synuara

Në vitin 2022, 81.3% e donacioneve u fokusuan në nevojat afatshkurtra humanitare, më e larta që nga viti 2013, kur filluam ndjekjen e filantropisë në Kosovë. Kjo përmbysi një prirje drejt dhurimit strategjik dhe afatgjatë, kryesisht për shkak të përqendrimit të lartë të donacioneve për lehtësimin e varfërisë.



Ky infografik është bërë i mundur nga mbështetja bujare e popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përbajtja është përgjegjësi e Catalyst Balkans dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara. Programi për Angazhim Qytetar në Kosovë është një iniciativë pesë vjeçare zbatuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).